

Organizohet të herë të parë në Shqipëri Forumi Global për Pensionet Private

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-tetor 2019
- Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 30.09.2019
- Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 30.09.2019

Zhvillime të tjera

- Zhvillime të rëndësishme e dialog konstruktiv shënuan ditët e mbledhjeve të Komiteteve Teknike, Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore dhe Forumin Global për pensionet private të OECD/IOPS
- Organizohet konferenca vjetore e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime
- Zhvillohet në Francë seminari ndërkombëtar me temë “Mbikëqyrja efiçente e tregjeve, mjete dhe sfida”
- Zhvillohet konferenca evropiane e instituteve kombëtare për edukim në tregun e sigurimeve

Edukimi i Konsumatorit

- Skema e Pensioneve në Poloni, Portugali dhe Sllovakia

Botime Profesionale

- Global Risk Regulator, volumi 17, nëntor 2019

Lajme Ndërkombëtare

- Bullgari
- Gjermani
- Kosovë
- Mali i Zi
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Organizohet të herë të parë në Shqipëri Forumi Global për Pensionet Private

Forum Global për Pensionet Private “Zhvillimi dhe mbikëqyrja e marrëveshjeve për fondet e pensioneve” nisi punimet, më 7 nëntor 2019, në Tiranë. Forumi u organizua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve, (IOPS) dhe Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD).

○ ○ ○

Në forumin më të madh për tregjet financiare të zhvilluar ndonjëherë në Shqipëri morën pjesë përfaqësues nga autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse, ekspertë të nivelit të lartë nga industria e fondeve private të pensionit nga vendet anëtare të të dyja organizatave OECD dhe IOPS.



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi duke mbajtur fjalën përshëndetëse të Forumit

Në forumin më të madh për tregjet financiare të zhvilluar ndonjëherë në Shqipëri morën pjesë përfaqësues nga autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse, ekspertë të nivelit të lartë nga industria e fondeve private të pensionit nga vendet anëtare të të dyja organizatave OECD dhe IOPS.

Në fjalën e mbajtur në nisje të punimeve, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Koçi theksoi se për Autoritetin është privilegj dhe përgjegjësi e lartë organizimi i Forumit Global të Pensioneve Private për herë të parë në Tiranë. Aktivitete të këtyre përmasave përveç shkëmbimit të eksperiencave dhe praktikave më të mira midis rregullatorëve të tregjeve financiare shërbejnë më së miri për të promovuar Shqipërinë në Botë, tha ai.

“Kjo është konferenca më e rëndësishme dhe me pjesëmarrjen më të madhe për tregjet financiare që është zhvilluar ndonjëherë në Shqipëri. Dhe kjo do të thotë shumë për Autoritetin dhe politikbërësit ku në bashkëpunim kemi një projekt ambicioz për zhvillimin e tregut të kapitaleve, specifikisht edhe për tregun e pensioneve. Si objektivi të përbashkët synojmë të kalojmë nga një treg modest i pensioneve private në një treg të konsoliduar nën një mbikëqyrje të kujdesshme në funksion të rritjes së mirëqënies dhe zhvillimit të tregut, duke e kthyer atë në një aset për ekonominë,” u shpreh Z. Koçi.

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Znj. Anila Denaj u ndal te rëndësia e zhvillimit të tregut të pensioneve private, në funksion të rritjes së mirëqënies për qytetarët dhe largimit të presionit nga skema shtetërore e pensioneve.

Forumi u përshëndet nga presidentja e sapozgjedhur e Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS), Znj. Helen Rowell, e cila u votua në Shqipëri nga anëtarët e Komitetit Ekzekutiv për një mandat 2-vjeçar dhe Sekretari i Përgjithshëm, Z. Andre Laboul.

Temat kryesore që u trajtuan në Forum përgjatë dy ditëve të punimeve të tij, lidheshin me: Reformat e pensioneve në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore gjatë 20 viteve të fundit; Zhvillimet e qëndrueshme për fondet e pensioneve: çështje të politikave rregullatore dhe mbikëqyrëse; Hartim i mirë i planeve të pensioneve me kontribut të përcaktuar: Udhëzuesi i OECD; Mënyra për të ndërtuar dhe mbikëqyrur marrëveshjet e pensioneve të mbështetura nga punëdhënësi; Fondet e pensioneve dhe ndërthurja me tregun e kapitaleve.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-tetor 2019


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-tetor kapën vlerën mbi 14,289 milionë lekë, ose 3.94% më shumë se në periudhën janar-tetor 2018. Gjatë periudhës janar-tetor 2019, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,105,059 me një rritje 3.43% krahasuar me periudhën janar-tetor 2018.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.64% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 6.91% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.45%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 36.30% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 63.70% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-tetor 2019, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 5,034 milionë lekë, ose 5.80% më shumë se në periudhën janar-tetor 2018.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-tetor kapën vlerën mbi 14,289 milionë lekë, ose 3.94% më shumë se në periudhën janar-tetor 2018.


Struktura e tregut të sigurimeve, janar-tetor 2019 (Në %)



Zhvillimet e Tregut të Pensioneve Private Vullnetare, 30.09.2019

Gjatë nëntëmuorit të vitit 2019, në tregun e pensioneve private vullnetare ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni. Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 30.09.2019 tregon një total asetesh neto prej 2,747.46 milionë lekë (22.50 milionë euro[1]) dhe me një rritje prej 458.36 milionë lekë (20.02%) krahasuar me 31.12.2018. Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 30.09.2019 është 27,247 anëtarë duke shënuar rritje prej 7.70% krahasuar me 31.12.2018.

Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve, 30.09.2019 (Në %)



Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve, më 30.09.2019 është 27,247 anëtarë duke shënuar rritje prej 7.70% krahasuar me 31.12.2018.

Tregues të fondeve të pensioneve

Përshkrimi	Vlera (mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)
	31.12.'18	30.09.'19	31.12.'18-30.09'19
Asetet neto të FP	2,289.10	2,747.46	20.02

Asetet neto dhe numri i anëtarëve, 30.09.2019


Fond Pensioni	Numri i anëtarëve në FP	Asete Neto (mln. lekë)
SIGAL	7,414	1,249.55
RAIFFEISEN	3,027	717.47
CREDINS PENSION	16,806	780.44
TOTAL	27,247	2,747.46

[1] <http://www.bankofalbania.org/> Kursi zyrtar i këmbimit ("fiksi") 30.09.2019 në Bankën e Shqipërisë, 1 euro = 122.11 lekë

Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 30.09.2019

Gjatë nëntëmuorit të vitit 2019, në tregun e fondeve të investimeve ushtruan aktivitetin e tyre pesë fonde investimi. Fondi i investimeve “Raiffeisen Prestigj”, fondi i investimeve “Raiffeisen Invest Euro”, fondi i investimeve “Raiffeisen Vizion” të cilat administrohen nga shoqëria “Raiffeisen Invest”, fondi i investimeve “Credins Premium” nën administrimin e shoqërisë administruese “Credins Invest” dhe fondi “WVP Top Invest” e cila administrohet nga shoqëria “WVP Fund Management Tirana sh.a”.

Ndarja e tregut sipas numrit të anëtarëve, 30.09.2019 (Në %)



Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 30.09.2019, vlera neto e aseteve të Fondeve, arriti rreth 66.68 miliardë lekë me një rritje prej 0.60 miliardë lekë ose 0.90%, krahasuar me 31.12.2018.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 30.09.2019, vlera neto e aseteve të Fondeve, arriti rreth 66.68 miliardë lekë me një rritje prej 0.60 miliardë lekë ose 0.90%, krahasuar me 31.12.2018. E shprehur në euro, totali i aseteve neto është 546 milionë Euro.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare, të cilat përbëjnë 60.44% të aseteve të fondeve, me një ulje prej 4.83% krahasuar me 31.12.2018.

Numri i anëtarëve që kanë investuar në Fondet e Investimit më 30.09.2019 është 29,280 me një ulje prej 0.48% krahasuar me 31.12.2018.

Tregues të Fondeve të Investimeve, 30.09.2019

Përshkrimi	Vlera (mln. lekë)		Ndryshimi (Në %)
	31.12.'18	30.09.'19	31.12.'18-30.09'19
Asetet neto të FI	66,087	66,684	0.90

Asetet neto dhe numri i anëtarëve, 30.09.2019

Fond Investimi	Numri i anëtarëve në FI	Asete Neto (mln. lekë)
Raiffeisen PRESTIGJ	21,339	42,379
Raiffeisen VIZION	3,762	10,679
Raiffeisen EURO	3,148	9,835
Credins PREMIUM	916	3,689
WVP Top Invest	115	103
TOTAL	29,280	66,684

ZHVILLIME TË TJERA

Zhvilleme të rëndësishme e dialog konstruktiv shënuan ditët e mbledhjeve të Komiteteve Teknike, Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore dhe Forumin Global për pensionet private të OECD/IOPS

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve, (IOPS) dhe Organizatë për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) përfunduan Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore si edhe mbledhjet e komiteteve teknike të IOPS të cilat u pasuan nga 2 ditë intensive të Forumit Global për pensionet private. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë ishte vendi mikpritës i këtyre aktiviteteve.

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve, (IOPS) dhe Organizatë për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) përfunduan Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore si edhe mbledhjet e komiteteve teknike të IOPS të cilat u pasuan nga 2 ditë intensive të Forumit Global për pensionet private.



Zj. Helen Rowell, Nënkryetare e Autoritetit Australian të Rregullimit Prudencial u zgjodh edhe Presidente e IOPS. Duke përshëndetur punimet e Forumit Global, Zj. Rowell theksoi se ky forum i OECD/IOPS për pensionet private “na dha një mundësi të shkëlqyer të debatojmë, mësojmë nga përvojat e njëri-tjetrit dhe të kërkojmë së bashku për ide të reja dhe qasje inovative për të adresuar sfidat kryesore me të cilat përballen sistemet e pensioneve”.

Ndërkohë që jepte një pasqyrë të zhvillimeve në sistemin e pensioneve private, Zj. Rowell nënvizoi se "sistemet e pensioneve janë duke u ripërshtatur në të gjithë botën, përfshirë në Shqipëri. Ato po përballen me sfida serioze (siç janë plakja e popullsisë, jetëgjatësia e rritur si dhe mjedisi aktual i rritjes së ulët dhe normave të ulëta të interesit) që e bëjnë detyrën e mbikëqyrjes së pensioneve edhe më të rëndësishme dhe sfiduese si nga dimensionet mikro-prudenciale ashtu edhe nga makro-prudenciale.

Synimi i IOPS është ta bëjë mbikëqyrjen e sistemeve private të pensioneve më efikase përmes shkëmbimit të përvojave më të mira mbikëqyrëse, aktiviteteve për vendosjen e standarde, bashkëpunimit dhe dialogut për politikat.”

—○○○—
Duke vlerësuar organizimin në Tiranë të këtij Forumi, Z. Ervin Koçi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së theksoi rëndësinë e madhe që ka shkëmbimi i eksperiencave me të gjithë rregullatorët e pranishëm në këtë forum.
—○○○—

Z. André Laboul, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS), dhe Këshilltar i Lartë Financiar në OECD, gjatë Forumit theksoi se “prej dekadash OECD mbështet diversifikimin e të ardhurave të pensionit që mund të arrihet përmes kombinimit të pensioneve publike dhe marrëveshje për pensionet private”. Regjimet e forta rregullatore dhe mbikëqyrëse, edukim financiar i përshtatshëm, eficient si edhe tregje më të thella të kapitalit janë thelbësore për zhvillimin e skemave të tilla private të pensioneve, temë kjo, e cila ishte në thelb të Forumit Global të OECD/IOPS të organizuar në Tiranë dhe në këtë drejtim, Z. Laboul e konsideroi se reforma shqiptare po shkon në drejtimin e duhur.

Gjithashtu, Z. Laboul theksoi se “rregullatorët dhe mbikëqyrësit duhet të udhëzojnë fondet e pensioneve që përballen me peizazhin e ri ekonomik, siç është nevoja për të integruar faktorët ESG (mjedis, social dhe qeverisje) në investimet e tyre dhe proceset e menaxhimit të rreziqeve, siç u arrit me udhëzimet e reja kryesore të IOPS të sapo prezantuara dy javë më parë”.

E organizuar në Tiranë në bashkëpunim me AMF, forumi pati një audiencë mjaft të lartë dhe diskutime të gjalla me ndërveprimin e audiencës. Panelistët gjatë forumit eksploruan tematika që lidhen me reformat e pensioneve në Evropën Qendrore, Lindore dhe Jug-Lindore gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit, zhvillimet e qëndrueshme për fondet e pensioneve dhe ndërthurja e tyre me tregun e kapitalit, hartimin e planeve të pensioneve me Kontribut të Përcaktuar, etj. Panelistët diskutuan edhe rolin e mbikëqyrësve për zhvillimin e thelluar të pensioneve private vullnetare.

Duke vlerësuar organizimin në Tiranë të këtij Forumi, Z. Ervin Koçi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së theksoi rëndësinë e madhe që ka shkëmbimi i eksperiencave me të gjithë rregullatorët e pranishëm në këtë forum. Z. Koçi nënvizoi punën e Autoriteti për zhvillimin e tregut të kapitaleve, specifikisht edhe për tregun e pensioneve, duke synuar të kalojmë nga një treg modest i pensioneve private në një treg të konsoliduar nën një mbikëqyrje të kujdeseshme në funksion të rritjes së mirëqenies dhe zhvillimit të tregut, duke e kthyer atë në një aset për ekonominë”.

Në takimet e Komiteteve Ekzekutive dhe gjatë Konferencës Vjetore u morën vendime të rëndësishme për bashkëpunimin ndërkombëtar, projektet në vazhdimësi të IOPS dhe u diskutua dhe aprovua plani i punës i IOPS për 2019-2020.

Organizohet konferenca vjetore e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime

Në datat 14-15 nëntor, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mori pjesë në mbledhjen e Komiteteve Teknike dhe Ekzekutive si dhe në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) në Abu Dabi, Emiratet e Bashkuara Arabe. Në konferencën vjetore me titull “Mbikëqyrja në epokën dixhitale” u diskutua në lidhje me sfidat me të cilat përballen rregullatorët në mbarë botën përballë zhvillimeve të vullshme teknologjike.

Në konferencën vjetore me titull “Mbikëqyrja në epokën dixhitale” u diskutua në lidhje me sfidat me të cilat përballen rregullatorët në mbarë botën përballë zhvillimeve të vullshme teknologjike.

Aktiviteti u hap me fjalët përshëndetëse të Sekretarit të Përgjithshëm të IAIS, Jonathan Dixon dhe kreut të Komitetit Ekzekutiv, Vicky Saporta. Më tej u shpалosën arritjet e Shoqatës Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve përgjatë vitit 2019 dhe sfidat për vitin e ardhshëm. Temat kryesore të trajtuara në konferencë ishin:

- Mbikëqyrja në epokën dixhitale, a jemi gati?
- Siguria kibernetike në tregun e sigurimeve;
- Të dhënat dhe inovacioni, mundësi dhe sfida;
- Përfshirja financiare dixhitale, inovacioni përtej imagjinatës;
- Ndikimi i teknologjisë në strukturën e tregut dhe qasjet efektive ndaj mbikëqyrjes.

Përgjatë dy ditëve të konferencës, panelistët dhe jo vetëm shkëmbyen përvojat e tyre dhe debatuan në lidhje me përmirësimet e mundshme rregullatore në favor të mbikëqyrjes efektive.

Zhvillohet në Francë seminari ndërkombëtar me temë “Mbikëqyrja efiсiente e tregjeve – mjete dhe sfida”

Në datat 25-28 Nëntor 2019 në Paris, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mori pjesë në Seminarin Ndërkombëtar 2019 me temë: “Mbikëqyrja efiсiente e tregjeve – Mjete dhe Sfidat” ku u trajtuan tema që kanë të bëjnë me përgatitjen që Britania e Madhe të largohet nga BE dhe efektet e pritshme.

Sfidat kryesore përfshijnë gjetjen e mënyrave për forcimin e tregjeve të kapitalit në BE, rritjen e konkurrencës dhe adresimin e problemeve digjitale dhe mjedisore.

Gjatë seminarit, të pranishmit u informuan se si Autoriteti Rregullator i Tregjeve Financiare të Francës (AMF) përmbush detyrat kryesore dhe prioritetet e tij në këtë kontekst. Në seminar u paraqitën prezantime mbi:

- Zbulimin dhe adresimin e rrezikut;
- Edukimin dhe mbrojtjen e investitorëve;
- Mbikëqyrjen e tregjeve, pjesëmarrësve dhe produkteve të tyre;
- Zbatimin, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar.

Financat e qëndrueshme dhe dixhitale, për të cilat Autoriteti Rregullator i Tregjeve Financiare të Francës ka fituar përgjegjësi të reja me miratimin e ligjit PACTE (Plani i Veprimit për Rritjen dhe Transformimin e Biznesit) ishin në rendin e ditës përgjatë seminarit.

Zhvillohet konferenca evropiane e instituteve kombëtare për edukim në tregun e sigurimeve

Akademia Gjermane e Sigurimeve (Deutsche Versicherungsakademie), me mbështetjen e Organizatës Evropiane të Instituteve Kombëtare për edukim në sigurime zhvilluan në datat 21-23 nëntor në Mynih, Gjermani, konferencën evropiane të instituteve kombëtare për edukim dhe formim profesional në tregun e sigurimeve.

Qëllimi i kësaj konference ishte shkëmbimi i ideve dhe përvojave më të mira në çështjet e edukimit në tregun e sigurimeve.

Institutet Kombëtare për edukim dhe formim profesional në tregun e sigurimeve të organizatave anëtare të Bashkimit Evropian pjesëmarrëse në këtë konferencë, përmes prezantimeve të tyre, ndanë zhvillimet e reja në tregjet vendase.

Gjatë konferencës u diskutuan zhvillimet në teknologji në tregun e sigurimeve dhe mënyrat për t'i kaluar sfidat e së ardhmes dixhitale, duke u përqendruar tek edukimi financiar. Disa nga çështjet e trajtuara ishin:

- Punët e reja në sigurimeve – Roli i partnerëve socialë;
- Mësimi dhe trajnimi në industrinë e sigurimeve 2030;
- Mësimi dhe trajnimi 2030, shembuj nga akademitë e sigurimeve;
- Të punosh dhe të mësosh në epokën e “makinerive të zgjuara”.

Institutet Kombëtare për edukim dhe formim profesional në tregun e sigurimeve të organizatave anëtare të Bashkimit Evropian pjesëmarrëse në këtë konferencë, përmes prezantimeve të tyre, ndanë zhvillimet e reja në tregjet vendase.

Skema e Pensioneve në Poloni

Informacioni i mëposhtëm është sipas:
<http://www.iopsweb.org>

GDP për frymë (USD)	29,000
Popullsia (000)	38,000
Forca e punës (000)	16,000
Shkalla e punësimit (%)	66

Pensionet publike

Ekziston një skemë e detyrueshme PAYG me kontribute të përcaktuara në Fondin e Sigurimeve Shoqërore (FUS) të drejtuar nga Institucioni Shtetëror i Sigurimeve Shoqërore (ZUS). Moshë e daljes në pension për personat e lindur pas vitit 1949 është 65 vjeç për burrat, pas plotësimit të 25 viteve punë dhe 60 vjeç për gratë, pas plotësimit të 20 viteve punë. Midis viteve 1999 dhe 2014, për shumicën e punonjësve, kontributet e pensionit të detyrueshëm u ndanë midis Fondit të Sigurimeve Shoqërore dhe fondeve të pensioneve të hapura (ish kolona e detyrueshme II). Që nga reforma e pensioneve në vitin 2014, e cila krijoi mundësinë për të hequr dorë nga fondet e pensioneve të hapura, më shumë se 80% e të punësuarve kontribuojnë vetëm në Institucionin Shtetëror të Sigurimeve Shoqërore.

Pensioni profesional vullnetar

Plani duhet t'u ofrohet më shumë se 50% të të punësuarve në kompani dhe të regjistrohet në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare Polake.

Pensioni personal vullnetar (i lidhur me punësimin)

Reforma e pensioneve të vitit 1999 prezantoi transformimin e mëposhtëm nga sistemi me përfitime të përcaktuara PAYG: çdo person i mbuluar nga sistemi kombëtar i sigurimeve shoqërore dhe i lindur pas 31 dhjetorit 1968 u kërkua të bashkohej me një plan të detyrueshëm të pensioneve personale. Të vetëpunësuarit gjithashtu duhej të merrnin pjesë në sistemin e ri, por u lejohej të paguanin nivele më të ulëta të kontributit. Njerëzit që nuk përzgjedhën një plan personal të detyrueshëm, u shpërndanë rastësisht në një fond pensioni të kualifikuar nga rregullatori.

Pensioni personal vullnetar (jo i lidhur me punësimin)

Kontributet në llogaritë e pensioneve individuale (IKE) dhe llogaritë individuale të sigurimit të pensioneve (IKZE) mbështeten në bazën e fitimeve pas taksës dhe nuk mund të kalojnë 150% të pagës mesatare mujore në mënyrë që të kualifikohen për përjashtim nga tatimi. Përfitimet kryesore të kursimeve vullnetare të pensioneve personale janë mospagim tatimi mbi të ardhurat nga kapitali. IKZE gjithashtu ofron mundësinë e zbritjeve të tatimit mbi të ardhurat personale (skema EET) që mund të jetë tërheqëse për njerëzit me të ardhura më të larta.

Baza ligjore

1997: Akti i Organizimit dhe Funkcionimit të Fondeve të Pensionit i 28 gushtit 1997 (me ndryshimet e mëvonshme madhore në 2003, 2011 dhe 2013);

2004: Akti i Llogarive të Pensioneve individuale dhe i Llogarive të sigurimeve të pensionit individual të datës 20 prill

<http://www.oecd.org/daf/fin/private-pensions/42575000.pdf>

2004: Akti i Programeve të Pensioneve të Punonjësve të 20 Prillit 2004;

<https://www.ilo.org/dyn/natlex/docs/ELECTRONIC/69016/91739/F123629596/POL69016.pdf>

2018: Akti i Planeve të Kapitalit të Punonjësve të 4 Tetorit 2018 (për të hyrë në fuqi në 2019)

<https://www.mojeppk.pl/pliki/repozytorium-plikow/materialy-do-pobrania/pdf/PFR-PPK-Poradnik-dla-pracownika-ENG.pdf>

Skema e Pensioneve në Portugali

Informacioni i mëposhtëm është sipas:
<http://www.iopsweb.org>

GDP për frymë (USD)	32,554
Popullsia (000)	10,300
Forca e punës (000)	5,219
Shkalla e punësimit (%)	67.8

Pensionet publike

Portugalia ka një skemë pensioni publik të lidhur me të ardhurat që mbulon personat e punësuar dhe ata persona të vetëpunësuar që fitojnë më shumë se gjashtëfishin e pagës minimale. Ekzistojnë sisteme të ndara për nëpunësit civilë, minorët, punëtorët e hekurudhave, peshkatarët dhe detarët tregtarë, por ato zakonisht do të unifikohen me sistemin e përgjithshëm. Për tu kualifikuar si vit kontributi, personi i siguruar duhet të ketë qenë në punë të paguar për të paktën 120 ditë. Kontributet arrijnë në 11% të të ardhurave bruto për të punësuarit dhe 23,75% të pagës për punëdhënësit.

Pensionet vullnetare profesionale

Planet e pensioneve mund të jenë me përfitime të përcaktuara, me kontribute të përcaktuara ose hibride. Shumica e planeve profesionale janë plane me përfitime të përcaktuara, por ka një prirje drejt kalimit tek modeli me kontribute të përcaktuara. Në lidhje me planet e përfitimeve të përcaktuara, formula për llogaritjen e përfitimeve varet nga dispozitat specifike të planit të pensionit ose marrëveshjes kolektive të punës, në bazë të së cilës përcaktohet plani. Për sa i përket pensionit të sigurimeve shoqërore (SSP), planet e përfitimeve të përcaktuara mund të klasifikohen si:

Plotësuese të integruara, nëse pensioni i dhënë nga plani është plotësues i pensionit të sigurimeve shoqërore dhe llogaritet si më poshtë: $PP = TP - SSP$, ku TP = pension i përgjithshëm që do të merret nga përfituesi, PP = pension i atribuar nga plani dhe SSP = pension i sigurimeve shoqërore;

Plotësues jo të integruara, nëse ekziston një kufi i sipërm i llojit $TP = PP + SSP < \% e\ pagës\ përfundimtare / e\ mesatares\ së\ pagave\ të\ fundit$;

E pavarur, nëse pensioni i dhënë nga plani është plotësisht i pavarur nga pensioni i sigurimeve shoqërore.

Në fund të 2017, më shumë se dy të tretat e planeve me përfitime të përcaktuara u klasifikuan si të pavarura. Mosha normale e pensionit në 2018 është 66 vjet dhe katër muaj në sektorin privat dhe publik.

Pensioni personal vullnetar

Marrëveshjet e kursimit të pensionit personal marrin një nga format e mëposhtme:

- Skemat e kursimit të pensionit personal, të njohura edhe me akronimin e tyre, PPR, të financuara nga kontratat e sigurimeve, fondet e pensionit ose fondet e investimeve.
- Anëtarësimi individual i fondeve të pensionit të hapur: kontratat individuale që specifikojnë kontributet në një fond pensioni në këmbim për të cilin përfitimet do të paguhen kur anëtarët arrijnë në një moshë të veçantë pensioni.
- Në fund të vitit 2017, totali i aktiveve në sistemin personal arriti në 18.1 miliardë euro (21.7 miliardë dollarë), me shpërndarjen e mëposhtme: 80.1% për PPR të financuar nga kontratat e sigurimeve, 12.6% për PPR të financuara nga fondet e investimeve, 3% për PPR financohen nga fondet e pensioneve dhe 4.3% për anëtarësim individual të fondeve të pensioneve të hapura.

Baza Ligjore

<http://www.iopsweb.org/resources/44874205.pdf>

<https://www.asf.com.pt/NR/exeres/97C24D91-5FD7-4874-9D7D-FFE049D206D9.htm>

Ligji 12/2006 i 20 Janarit – i ndryshuar, përcakton regjimin ligjor të zbatueshëm për fondet e pensioneve dhe subjektet e tyre drejtuese, duke zhvendosur Direktivën e BE 2003/41 / EC, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të 3 qershorit, mbi veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e institucioneve për sigurimin e pensionit profesional në kornizat ligjore portugeze.

Ligji 147/2015 i 9 shtatorit – i ndryshuar , miraton kornizën ligjore për biznesin e sigurimeve dhe risigurimeve.

2018: Kuadri rregullator portugez i zbatueshëm për pensionet private është aktualisht në rishikim në kontekstin e zhvendosjes drejt Direktivës IORP II.

Skema e Pensioneve në Sllovaki

Informacioni i mëposhtëm është sipas:
<http://www.iopsweb.org>

GDP për frymë (USD)	15,000
Popullsia (000)	5,000
Forca e punës (000)	2,700
Shkalla e punësimit (%)	72

Që prej reformave të vitit 2005, sistemi i pensioneve është i përbërë nga të tre shtyllat që përfaqësojnë pensionet publike të detyrueshme (kolona e parë PAYG), sistemi i pensioneve private të detyrueshme (kolona e dytë) dhe sistemi i pensioneve suplementare (kolona e tretë).

Pensionet Publike (Kolona 1)

Kontributet në sistemin e pensioneve publike për ata që nuk bëjnë pjesë në planet e pensionit privat, arrijnë në 14% të bazës së vlerësimit të punëmarrësit për punëdhënësin dhe 4% të bazës së vlerësimit të punonjësve për punonjësit.

Sistemi i pensioneve private të detyrueshme (Kolona 2)

Skema është e hapur për individë, të punësuar dhe vetëpunësuar, më të rinj se 35 vjeç. Numri i kursimtarëve të regjistruar në këtë skemë më 31 Dhjetor 2017 ishte 1.425.843 persona.

Kontributet e sigurimeve shoqërore përbëjnë 18% të pagës së një punonjësi. Në 2018 13,50% e kësaj përqindje shkon në skemën e pensioneve publike (9,50% nga punëdhënësi, 4% nga punëmarrësi), ndërsa 4,50%, i paguar në tërësi nga punëdhënësi, shkon në kompaninë e administrimit të fondeve të pensionit (PFMC) e zgjedhur nga anëtari. Shkalla e kontributeve do të rritet çdo vit me 0,25% çdo vit dhe do të arrijë nivelin e synuar 6% në vitin 2024.

Pensioni suplementar (Kolona 3)

Skema është e hapur për individët mbi 18 vjeç. Punonjësit dhe punëdhënësit mund të kontribuojnë në llogaritë e kursimeve vullnetare, ku shumica e punëdhënësve japin kontribute nën kushtet e marrëveshjeve kolektive. Punonjësit dhe punëdhënësit nënshkruajnë kontrata të ndara me një kompani të menaxhimit të pensioneve suplementare (SPMC). Të vetëpunësuarit dhe individët, punëdhënësit e të cilëve nuk kontribuojnë, gjithashtu mund të futen në një marrëveshje pensioni vullnetar, pavarësisht nga marrëveshjet e tyre të punës.

Një pension suplementar i paguhet një pjesëmarrësi kur:

I lind e drejta të marrë një pension të sigurimeve shoqërore, pension të parakohshëm ose kur arrin moshën e daljes në pension.

Plotëson periudhën minimale të kursimit të pensionit suplementar për profesionet e njohura nga legjislacioni si të dëmshëm dhe ka arritur moshën e nevojshme prej 55 vjetësh. Periudha minimale e kursimit të pensionit suplementar nuk mund të jetë më e shkurtër se 10 vite.

Baza ligjore

https://www.nbs.sk/_img/Documents/_Legislativa/_FullWordingsOthet/A650-2004.pdf

https://www.nbs.sk/_img/Documents/_Legislativa/_BasicActs/A43-2004.pdf

http://www.ilo.org/dyn/natlex/natlex4.detail?p_lang=en&p_isn=67708

GLOBAL RISK REGULATOR

Volumi 17, nëntor 2019 përmban këto shkrime kryesore:

- Bordi i Stabilitetit Financiar (FSB) paralajmëron G20 për shfaqjen e rreziqeve rregullatore
(*FSB warns G20 of emerging regulatory risks*)
- Bordi i Stabilitetit Financiar (FSB) sheh përparim të kufizuar përsa i përket zbatimit të reformave derivative OTC
(*FSB sees limited further progress on implementing OTC derivatives reforms*)

Global Risk Regulator
A PUBLICATION FROM THE BANKER November 2019 | Volume 17, Issue 10

Contents

- 7 **FS Regulatory Round-up**
Global need to curb their enthusiasm over green supporting factors
- 11 **Banks rethinking businesses** in face of climate change
- 13 **Open banking impact** may force regulators to reconsider prudential measures
- 15 **ESMA** could become global standard setter for operational resilience testing
- 17 **Newsflash** (1-2019)
- Financial firms call for CCPs to have more skin in the game
- IEA 2020 work programme

Spot FX market gears up to fend off MAR threat

ESMA has put the cat among the pigeons in the spot FX market by asking in a consultation whether it should come under MAR with the industry now wondering how it can fend off any such attempt. *By Justin Pugley*

As they age, EU regulations have a tendency to creep into new areas and there was a hint of that in progress to review the market abuse regulation (MAR) with the suggestion that the spot foreign exchange market could come under the regime.

This was the stated aim in the European Securities and Markets Authority's (ESMA) proposal dated October 1, as MAR chafes up its third anniversary.

The mere suggestion of this market coming under MAR has sparked ripples of anxiety among spot FX market participants.

There is no guarantee that this will occur, but if it were to happen, making it work would be challenging. Not least that MAR complements the markets in financial instruments directive (MiFID II), which largely applies to trading venues, and not spot FX. It is an over-the-counter (OTC) market dominated by bilateral deals that stretch across the world.

The rest of the document was a mix of guidance and questions about technical issues.

The ESMA consultation is happening because under article 38 of MAR, the European

Simon Majster

to page 2

Bullgari

www.xprimm.com

Për 3-mujorin e tretë të vitit 2019, primet e shkruara në Bullgari arritën në 2.18 miliardë leva (BGN, monedha vendase) ose 1.11 miliardë euro, me një rritje prej 17.17% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sigurimi i Jo-Jetës arriti në 923.97 milionë euro, me një rritje prej 17.38%.

Ndërsa sigurimi i Jetës arriti në 193.13 milionë euro, me një rritje prej 16.2%. Siguruesit në Bullgari paguan 449.62 milionë lekë dëme, me një rritje prej 10.44% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Gjermani

www.xprimm.com

Mesatarisht, 133 në 1000 banesa janë dëmtuar nga reshjet e shiut në Gjermani, nga viti 2002 deri në 2017, ndërsa shuma mesatare e shpenzuar nga gjermanët për të riparuar shtëpitë e tyre është 5,293 euro. Të dhënat janë publikuar si pjesë e një projekti kërkimor të Shoqatës së Siguruesve të Gjermanisë dhe Shërbimit Meteorologjik Gjerman.

Në periudhën 2002-2017 reshjet e shiut kanë shkaktuar 6.7 miliardë euro dëme në Gjermani, përfshirë edhe pronat e pasiguruara. Sipas studimit, çdo rajon në Gjermani është thuajse njësoj i rrezikuar nga moti i keq. Megjithatë, vetëm 43% e gjermanëve kanë një sigurim prone, duke qënë në këtë mënyrë të mbrojtur nga pasojat e motit ekstrem.

Kosovë

www.xprimm.com

Banka Qendrore e Kosovës, bazuar në analizën e Fondit Monetar Ndërkombëtar në lidhje me stabilitetin e sektorit financiar në vend, inicioi procesin e vlerësimit të primeve të riskut për siguracionin MTPL. Sipas Bankës Qendrore, tarifat e deritanishme nuk kanë ndryshuar që nga viti 2001. Banka Qendrore e Kosovës analizoi një raport të kompanive që operojnë në tregun vendas, ku rekomandohej rritja me 36.6% e tarifave dhe gjykoj që kjo masë nuk është e mundur. Në vend të kësaj, siguruesit u lejuan që të rregullojnë tarifat e siguracionit MTPL, bazuar në normën e inflacionit.

Ndërkohë, referuar të dhënave për 3-mujorin e tretë të vitit 2019, primet e shkruara bruto në Kosovë arritën në 74 milionë euro. Nga këto, 71.4 milionë euro janë prime të shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës, ndërsa 2.6 milionë janë për sigurimin e Jetës. Dëmet e paguara për këtë periudhë arritën në 37.9 milionë euro.

Mali i Zi

www.xprimm.com

Në 3-mujorin e tretë të vitit 2019, primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Malin e Zi arritën në 72.33 milionë euro, me një rritje prej 11.52% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 11.31%, duke arritur në 60.59 milionë euro. Ndërsa primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 12.62%, duke arritur në 11.73 milionë euro.

Turqi

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Turqi e mbylli 3-mujorin e tretë të vitit 2019 me 48.4 miliardë lira (TRY, monedha vendase) prime të shkruara bruto, me një rritje prej 22.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritje të konsiderueshme shënoi sigurimi i Jetës, gjë që ndikoi edhe në rritjen e peshës së tij në tregun e sigurimeve në Turqi. Edhe sigurimi i Jo-Jetës e mbylli 3-mujorin e tretë të vitit me rritje të mëdha.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al